Z. Kostandin Budurushi është inxhinier mekanik dhe hidroteknik, me mbi 29 vite përvojë në administratën publike dhe në sektorin e ndërtimit.

Karrierën e nisi në vitin 1997 si Shef Sektori në Shërbimet Publike pranë Këshillit të Rrethit Tiranë. Më pas ka mbajtur pozicionet e Drejtorit, Kryeinxhinierit dhe Drejtorit të Përgjithshëm në Ujësjellës Kanalizime Tiranë, ku ka drejtuar edhe sektorin e sistemeve infrastrukturore. Gjatë viteve 2010-2014 ka punuar në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, si Inspektor dhe Drejtor Inspektimi. Nga viti 2015 deri në dhjetor 2024 ka punuar si inxhinier zbatimi pranë shoqërisë “S.A.G.” shpk, në zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe rikonstruksionit të godinave.

Në Bashkinë Tiranë ka drejtuar drejtoritë e Emergjencave Civile dhe të Rindërtimit të Emergjencave, të ngarkuara me zvogëlimin dhe reagimin ndaj fatkeqësive natyrore dhe me rindërtimin pas tyre. Gjatë vitit 2024 ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, duke drejtuar tri drejtori dhe 27 njësitë administrative të Bashkisë Tiranë. Nga dhjetori 2024 deri në mars 2025 ka qenë Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Tiranë.

Ka përfunduar studimet për Inxhinieri Mekanike (1985-1990) dhe ka ndjekur studimet në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimi, dega Hidroteknik (2002-2004). Në vitet 1996-1997 ka ndjekur trajnimin institucional në Manaxhimin Industrial të Ndërmarrjeve. Zotëron gjuhë të huaja si Italisht dhe Gjermanisht.